



**Roli i Agjencisë kundër
Korrupsionit
në luftimin dhe parandalimin e
korrupsionit në Kosovë**



Agjencia kundër Korrupsionit



- Agjencia është institucion i pavarur i cili i ushtron përgjegjësitë me Ligjin nr. 03-L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit.
- Fondet për funksionimin e AKK-së sigurohen nga buxheti i Kosovës.
- Aktivitetet e AKK-së udhëhiqen nga Drejtori (të cilin e emëron Kuvendi i Republikës së Kosovës).
- AKK i raporton Kuvendit të Kosovës dhe mbikëqyret nga Komisioni parlamentar mbikëqyrës.




Baza ligjore me të cilin përcaktohet mandati i AKK-së



- Ligji nr. 03-L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit;
- Ligji nr. 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik, i amandamentuar me Ligjin nr. 03/L-155;
- Ligji nr. 03/L-151 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtarëve të lartë publik.



DREJTORI I AGJENCISË





Misioni i AKK-së



Luftimi i korrupsionit

- Përmes hetimit të rasteve të dyshuara për korrupsion dhe përcjellja e kallëzimeve penale në prokuroritë kompetente, kompletimi i legjislacionit në fushën kundër korrupsionit, përgatitja dhe zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit.

Parandalimi i korrupsionit

- Përmes parandalimit konfliktit të Interesit, mbikëqyrjes dhe kontrollit të pasurisë së zyrtarëve të lartë, mbikëqyrjes së pranimit të dhuratave

Edukimi

- Përmes ngritjes së vetëdijes kundër korrupsionit te zyrtarët publikë dhe qytetarët mbi kornizën ligjore dhe mekanizmat aktual anti-korrupsion.



Përgjegjësitë ligjore të AKK-së



- Inicon dhe zhvillon procedurën e zbulimit dhe hetimit paraprak të korrupsionit dhe përcjellë kallëzime penale për rastet e dyshimit për korrupsion në prokurorinë publike kompetente, nëse për të njëjtin rast nuk zhvillohet procedurë penale;
- Bashkëpunon me institucionet vendore, të huaja dhe ndërkombëtare që kanë për misionparandalimin dhe luftimin e korrupsionit;
- Në bashkëpunim me Komisionin, Qeverinë, institucionet e tjera dhe me organizatat joqeveritare, harton strategjinë kundër korrupsionit dhe planin e veprimit;
- Monitoron dhe mbikëqyrë zbatimin e Strategjisë kundër Korrupsionit dhe planin e veprimit;



Përgjegjësitë ligjore të AKK-së



- Mbikëqyrë dhe parandalon rastet e konfliktit të interesit dhe ndërmerr masat e parapara me ligj të veçantë;
- Mbikëqyrë pasuritë e zyrtarëve të lartë publik dhe personave të tjerë, siç parashihet me ligj të veçantë;
- Mbikëqyrë pranimin e dhuratave që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrës zyrtare dhe ndërmerr masat e parapara me ligj;
- Bashkëpunon me autoritetet publike kompetente për hartimin, harmonizimin dhe zbatimin e legjislacionit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit;



Përgjegjësitë ligjore të AKK-së



- Përfaqësohet në takime ndërkombëtare që kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit si dhe merr pjesë në procesin e negociatave për lidhjen e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale apo miratimin e instrumenteve ligjore ndërkombëtare kundër korrupsionit;
- Bashkëpunon me institucionet kompetente të Republikës së Kosovës për realizimin e detyrimeve që dalin nga aktet ndërkombëtare kundër korrupsionit dhe ofron rekomandime për përmbushjen e detyrimeve të tyre;
- Merr pjesë dhe ofron këshilla për hartimin e kodit të etikës në sektorin publik dhe privat;



Masat parandaluese kundër korrupsionit

- Mbikëqyrja e pasurive të zyrtarëve të lartë publik;
- Mbikëqyrja e pranimet të dhuratave dhe
- Parandalimi i konfliktit të interesit.



Parandalimi i konfliktit të interesit

Definicioni i konfliktit të interesit

Konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, kur gjatë ushtrimit të funksionit të tij zyrtari ose personi i afërt ka interes privat pasuror ose personal jo pasuror, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikon, ose mund të ndikoj në kryerjen në mënyrë të drejtë të funksionit publik, kur gjendet në situata të shkeljes së mundshme të parimeve, të kufizimeve dhe ndalesave apo detyrimeve, sipas dispozitave të këtij ligji.



Procedura për parandalimin e konfliktit të interesit



- Procedura para Agjencisë fillon zyrtarisht nga Agjencia, me kërkesën e udhëheqësit mbikëqyrës, organit mbikëqyrës të zyrtarit apo me kërkesën e vet zyrtarit.
- Agjencia mund ta fillojë procedurën në bazë të lajmërimit të ndonjë personi tjetër apo lajmërimit anonim.
- Agjencia e informon zyrtarin për fillimin e procedurës dhe me kërkesën e tij e njofton me faktet që posedon Agjencia.



Procedura për parandalimin e konfliktit të interesit



- Procedura nga Agjencia është e mbyllur për publikun.
- Agjencia i bën të njohura vetëm rezultatet përfundimtare të procedurës së zhvilluar.
- Agjencia në rast të dyshimit për ekzistimin e shkeljes do të njoftoj zyrtarin për të cilin ekziston dyshimi se ka bërë shkelje të rregullave të sjelljes të përcaktuara me këtë Ligj.
- Agjencia në mënyrë të pavarur i vërteton faktet, ndërsa institucionet tjera në kuadër të kompetencave të tyre janë të detyruara që pa shtyrje, sipas kërkesës së Agjencisë t'i vejnë në dispozicion faktet dhe të dhënat e kërkuara.



Procedura për parandalimin e konfliktit të interesit



- Në qoftë se zyrtari nuk heqë dorë nga ushtrimi i funksionit edhe pas njoftimit nga Agjencia, Agjencia kërkon nga institucioni në të cilin zyrtari ushtron veprimtarinë tij që ndaj zyrtarit të fillojë procedura e shkarkimit.
- Nëse shkelja ka dëmtuar interesin publik, atëherë Agjencia lajmëron rastin tek organet e ndjekjes.
- Nëse pas zgjedhjes, emërimit, ose konfirmimit të mandatit personi zyrtar vazhdon të kryej një aktivitet apo funksion që ky ligj e përcakton si të papajtueshëm me funksionin e ri, Agjencia e paralajmëron personin zyrtar dhe vendosë një afat (15 ditë deri në 3 muaj) sipas të cilit atij do t'i kërkohej të ndërprejë aktivitetin apo të heqë dorë nga posti.



Procedura për parandalimin e konfliktit të interesit



- Në rast se personi zyrtar vazhdon të kryej aktivitete apo funksione të papajtueshme, pavarësisht nga paralajmërimi i Agjencisë, atëherë Agjencia i propozon institucionit ku zyrtari ushtron funksionin që të nisë procedurën për shkarkimin e tij.
- Organi kompetent ku personi zyrtar vazhdon të kryej një aktivitet ose funksion të papajtueshëm me ligjin, fillon procedurën për shkarkimin nga funksioni sipas propozimit të Agjencisë.
- Në rastet kur deputeti i Kuvendit ushtron aktivitete të papajtueshëm me Ligjin, Agjencia e njofton Kryetarin e Kuvendit për veprimin e deputetit që ta ndërpresë aktivitetin e papajtueshëm.
- Lidhur me veprimet e ndërmarra sipas propozimit të Agjencisë, institucionet kompetente menjëherë duhet ta njoftojnë Agjencinë.



Tabela e rasteve të trajtuara për konflikt interesi



Janar – Dhjetor 2008

Institucionet	Rastet e dyshuara për konflikt interesi	Rastet e shmangura	Rastet në shqyrtim	Rastet e mbyllura për mungesë provash
Kuvendi	12	0	2	10
Qeveria	29	16	4	9
Presidenca	1	1	0	0
Gjykatat	1	0	1	0
Pushteti lokal	1	1	0	0
Institucione tjera	1	1	0	0
Totali:	45	19	7	19



Tabela e rasteve të trajtuara për konflikt interesi



Janar – Dhjetor 2009

Nr	Institucioni	Raste të dyshuara për konflikt interesi	Rastet që i janë shmangur konfliktit të interesit	Rastet kur kemi dhënë opinjone	Rastet e mbyllura pa konflikt interesi	Rastet në procedurë
1.	Kuvendi i Kosovës	17	3	/	9	5
2.	Qeveria e Kosovës	25	3	/	18	4
3.	Institucionet tjera	5	/	5	/	/
	Totali:	47	6	5	27	9



Rastet e trajtuara për konflikt interesi, 2010



Janar – Dhjetor 2010

- Për periudhen janar–dhjetor 2010 rastet e konflikti të interesit janë në numër shumë më shumë se në 2 vitet paraprake, por Agjencia është akoma në përgatitje e sipër të raportit vjetor 2010.
-



Kontakti me AKK-në

- Përmes vizitave raportuese në zyret e AKK-së.
- Përmes linjës telefonike pa pagesë dhe konfidenciale – **044 082 82.**
- Përmes web faqes – www.akk-ks.org



**Faleminderit për
vëmendjen !
Pyetje ?**

20-21 janar 2011

Tiranë - Albania